



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KRYEMINISTRIA
ZËVENDËSKRYEMINISTRI

Nr. Prot. 3595/1

Tiranë, më 4.07.2017

LËNDA: Kërkesë për informacion - Kujtesë

DREJTUAR: Z. Haki Çako
Drejtor i Policisë

PËR DIJENI: Z. Dritan Demiraj
Ministër i Brendshëm

I nderuar Z. Drejtor,

Me shkresën nr. 3595, datë 27.06.2017 (*bashkëngjitur një fotokopje*) Zëvendëskryeministri kërkon informacion sipas përmbajtjes së shkresës në fjalë.

Lutemi dërgimin e informacionit të kërkuar së më shpejt të jetë e mundur pasi jemi duke përgatitur raportin përfundimtar lidhur me monitorimin e kryer nga Task-Forca për zgjedhjet sipas VKM nr. 473, datë 01.06.2017 “Për marrjen e masave dhe monitorimin e veprimtarisë, sjelljes apo përdorimit të burimeve njerëzore, financiare dhe logjistike të administratës shtetërore, gjatë procesit zgjedhor për zgjedhjet në Kuvendin e Shqipërisë”.

Informacionin që do të dërgoni me shkresë, për shpejtësi, lutemi ta dërgoni të skanuar në adresën e e-mailit: Sonila.Balla@kryeministria.al

ZËVENDËSKRYEMINISTRI

LEDINA MANDIJA





REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KRYEMINISTRIA
ZËVENDËSKRYEMINISTRI

Nr. Prot. 3595

Tiranë, më 27.06.2017

LËNDA: Kërkesë për informacion

DREJTUAR: Z. Dritan Demiraj
Ministër i Brendshëm

Z. Haki Çako
Drejtor i Policisë

Të nderuar,

Me VKM nr. 473, datë 01.06.2017 "Për marrjen e masave dhe monitorimin e veprimtarisë, sjelljes apo përdorimit të burimeve njerëzore, financiare dhe logjistike të administratës shtetërore, gjatë procesit zgjedhor për zgjedhjet në Kuvendin e Shqipërisë" është ngritur dhe funksionon Task-Forca, e cila koordinon procesin e monitorimit sipas këtij vendimi.

Së pari, në zbatim të detyrave të lëna nga Task-Forca në mbledhjen e datës 22.06.2017 dhe të masave operacionale për ditën e zgjedhjeve të miratuara nga Task-Forca në mbledhjen e datës 23.06.2017, lutemi dërgimin sipas tabelës bashkëlidhur, brenda ditës së nesërme, ora 10.00, të informacionit më poshtë:

1. Sa denoncime janë adresuar pranë institucionit tuaj për shkelje të administratës shtetërore gjatë procesit zgjedhor, përfshirë ditën e zgjedhjeve;
2. Sa nga këto raste janë trajtuar;
3. Për sa nga rastet e trajtuara nuk janë marrë masa administrative;
4. Për sa nga rastet e trajtuara janë marrë masa administrative;
5. Sa nga rastet e trajtuara janë referuar në prokurori;

Gjithashtu, bashkë me tabelën lutemi të dërgoni edhe formularët e plotësuar (pa provat) për rastet e denoncuar (sipas modelit të formularit bashkëngjitur).

Së dyti, nga ana e Policisë së Shtetit, në zbatim të masave operacionale për ditën e zgjedhjeve, të miratuara nga Task-Forca në mbledhjen e datës 23.06.2017, sipas tabelës bashkëlidhur, lutemi të dërgohet (nëse ka):

1. numrin e rasteve të referuara/konstatuara për përfshirje të punonjësve të policisë në mbështetje të subjekteve elektorale;
2. numrin e rasteve të referuara/konstatuara për bashkëpunim të punonjësve të policisë me elementë kriminalë;
3. numrin e rasteve të referuara/konstatuara për përdorim të parashë në mbështetje të subjekteve zgjedhorë;

Së treti, nga ana e Policisë së Shtetit, lutemi të dërgohet një analizë se si është monitoruar konkretisht veprimtaria e policisë së shtetit ditën e zgjedhjeve, dhe sipas rastit, problematikat e rezultuara dhe masat e marra.

Së katërti, mbështetur në planin operacional të masave të miratuara nga Task-Forca, nga ana e Ministrisë së Brendshme të dërgohet një analizë se si është monitoruar veprimtaria e policisë së shtetit, gardës dhe elementëve kriminalë ditën e zgjedhjeve.

Informacionin që do të dërgoni me shkresë, për shpejtësi, lutemi ta dërgoni të skanuar në adresën e e-mailit: Sonila.Balla@kryeministria.al

ZËVENDËSKRYEMINISTRI

LEDINA MANDIJA

